



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY


DEPARTAMENTI I TREGTISË
DEPARTAMENT TRGOVINE
DEPARTAMENT OF TRADE

Shkëmbimet tregtare te Kosovës Janar –Shtator / 2012

Shkëmbimet tregtare Janar – Shtator/ 2012, kane arritur vlerën prej 2.05 miliard euro . Kontributi i eksporteve ne volumin tregtare është 201mil/€ , rënie për 18% krahas nëntë mujorit te vitit te kaluar.

Kurse, vlera e importeve është prej 1,848.4 milion euro rritje prej 4.4% po për te njëjtën periudhe krahasuese.


Mbulimi i importeve nga eksporti brenda kësaj periudhe (Janar – Shtator, 2012) është 11%.



Edhe për këtë nënte mujor të këtij viti pjesa më e madhe e qarkullimit tregtar është realizuar nga vendet e BE-se duke kapur vlerën prej 801mil/€ ose 39.3% e shkëmbimeve të përgjithshme të Kosovës, importi nga këto vende ka arritur në 718 mil/€ ose 39% pjesëmarrje në importet e përgjithshme, rritje për 9.5% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu në eksportet e Kosovës rolin dominant e kanë vendet e BE-se, në këto vende janë realizuar 41% eksporteve të përgjithshme ose 82 mil/€, rënie për 20.6%. Brenda këtij grupimi vlen të ceket veçmas roli i Italisë ku janë eksportuar 27.2%, Gjermania 5.9% e totalit të eksportit si dhe vendet e tjera por me pjesëmarrje shumë më të vogël.


Shkëmbimet tregtar me vendet e CEFTA-s, ka arritur në 700 mil/€ ose 34% e shkëmbimeve të përgjithshme tregtare. Importi nga vendet e CEFTA-s për këtë periudhë kohore (Janar – Shtator 2012) ka arritur në 626 mil/€ ose 33.8% e totalit të importit., rënie për 2.5% në raporte me periudhën e njëjtë të vitit 2011. Në këtë grup vendesh kemi një dominim nga vendet si: Maqedonia 11.7%, Serbia 11.2%, Shqipëria 4.3% e totalit të importit në Kosovë.

Ndërsa sa i përket eksporteve në vendet e CEFTA-s janë prej 73 mil/€ ose 36.5% pjesëmarrje në eksportet e përgjithshme të Kosovës, rritje për 15.2 % krahas periudhës Janar – Shtator 2011, dominante janë: Shqipëria 14.9%, Maqedonia 9.4%, Mali i Zi 5.4% si dhe Serbia 5.2% pjesëmarrja në totalin e eksporteve për periudhën Janar – Shtator/2012.



Partneret kryesore eksportues, Janar- Shtator/ 2012 (%)

Italia	Shqipëria	Maqedonia	Gjermania	Zvicra	Mali i Zi	Serbia	Turqia
27.2	14.9	9.4	5.9	5.7	5.4	5.2	4.3



Partneret kryesore importues, Janar- Shtator/ 2012 (%)

Gjermania	Maqedonia	Serbia	Italia	Turqia	Kina	Shqipëria	Greqia
11.9	11.7	11.3	9	7.7	6.3	4.3	4.2

